Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e

prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	Afati
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Emertimi	Sasia
----------	-------

Numri i objekteve	161		
Totali i sipërfaqes ne m2	39,671.80		
Numri i personelit	Afersisht 2,000		
NR.	PERSHKRIMI	Njesia	Minimumi i Sasise/mujore
Materiale te higjenes personale	Letra duarsh	Pako	4000
	Letra kuzhine	Pako	1000
	Letra higjenike	Pako	1000
	Dezinfektant duarsh me baze alkooli min 60%	Lt	500
Aksesor pastrimi konsumi	Leckë pllakash	Cope	80
	Lecka mikrofibra	Cope	100
	Solucion WC	Cope	150
	Bishta	Cope	100
	Fshesa për ambiente të brendshme	Cope	100
	Shtupa per banjon	Cope	80
	Solucion pllakash (5 kg)	Cope	80
	Sapun likuid (5 kg)	Cope	100
	Aromë ambienti	Cope	80
	Ilac xhamash (1lt)	Cope	150
	Qese mbeturinash (100)	Pako	500
	Qese mbeturinash (70)	Pako	400
	Qese mbeturinash (50)	Pako	400
	Zbardhues-dezinfektant	Cope	150
	Doreza plastike	Cope	150
	Ilac per larjen e pllakave	Cope	100
	Sfungjer	Cope	100
	Acid (1 Lt)	Cope	50

	Sgrasatore	Cope	50
	Ilac per larjen e eneve 1000ml	Cope	50

1. Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh - minimumi 10 cope
2. Makineri larje-tharje- minimumi 3 cope
3. Fshesa korenti - minimumi 10 cope
4. Paisje për larjen e dritareve me gjatësi mbi 10 metra- 1 cope

Parametrat e makinerive profesionale duhet te jene si vijon;

1.Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh:

- a. Tipi i punes: pluhura dhe lengje
- b. Kapaciteti i vakumit: minimum 2200 mm/ss
- c. Vellimi i kazanit: minimum 20 litra
- d. Fuqia motorike: minimum 1300 W
- e. Rezervuar plastic
- f. Filter i pastrueshem

2.Makineri Larje -Tharje:

- a. Gjeresia e furces: minimum 400 mm
- b. Presioni i furcave: minimum 17 g/cm²
- c. Gjeresia e thithjes: minimum 600 mm
- d. Performance praktike: minimum 1000 m²/ore
- e. Rezervuari i ujit te paster: minimum 30 litra

3.Fshesa korenti:

- a. Tipi i punes: pluhura
- b. Vakuumi: minimum 2200 mm/ss
- c. Vellimi: minimum 6 litra
- d. Fuqiamotorike: minimum 1000 W
- e. Filter i pastrueshem

4.Pajisje per Iarjen e dritareve/fasadave:

Minimalisht duhet te permbaje keto specifikime:

- a. Membrane te kundert osmoze
- b. Pajisja e filtrit: filtra active e karbonit, I pajisje de-jonizuese rezine
- c. Pajisje karboni me fiber teleskopike 13.5 mmbajtese dore me meter
- d. pluhur per membranen ozmotike te filtrit te mirembajtjes
- e. Tubi kullimi
- f. Lubrifikues i copezuar

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim i pastrimit për zyrat dhe Qëndrat e Kujdesit Ndaj Klientit të OSHEE Group sh.a”.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

<i>Nr</i>	<i>Vendndodhja e Objektivit Zyre/KNK</i>	<i>Adresa</i>	<i>Shoqeria</i>	<i>Sipërfaqja në m²</i>
<i>Tirane</i>				
1	Zyrat Qendrore FSHU	Blv Gj. Fishta	FSHU sh.a	5,493.00
2	Arkiva Vaqarr	Vaqarr Tirane	FSHU sh.a	500
3	KNK Drejtoria Rajonale	Drejtoria Rajonale Tirane	FSHU sh.a	250
4	KNK, Tirane 1	Kompleksi Delijorgji Rruga e Kavajes	FSHU sh.a	200
5	KNK, Tirane 2	Kinostudio	FSHU sh.a	310
6	KNK, Tirane 3	Lagja "Ali Demi"	FSHU sh.a	103.5
7	KNK, Tirane 4	Komuna e Parisit, Tirane	FSHU sh.a	164
8	KNK, Tirane 5	Prokuroria e pergjithshme	FSHU sh.a	90
9	KNK, Tirane 6	Don Bosko	FSHU sh.a	105
10	KNK, Unaza e re	Prane pallatit Astir	FSHU sh.a	40
11	KNK, Myslym Shyri	rruga Myslym Shyri	FSHU sh.a	117.5
12	KNK, Misto Mame	Prane ish kombinatit Misto Mame	FSHU sh.a	160

13	KNK, Q.Studenti	Qyteti Studenti	FSHU sh.a	233
14	KNK, Kamez	Kamez	FSHU sh.a	250
15	KNK, Laprake	Laprake Tirane	FSHU sh.a	180
16	KNK Insitut	Insituti Tirane	FSHU sh.a	96.3
17	KNK Paskuqan	Paskuqan Tirane	FSHU sh.a	143.1
18	Arka, Banka Qendrore	Rr.Cameria, Arka nr.19, Tirane	FSHU sh.a	87
19	Arka, 21 dhjetori	Kryqezimi 21 dhjetori	FSHU sh.a	16
20	Arka, Libri Universitar	Libri universitar	FSHU sh.a	13
21	Arka, Kombinat	Kombinat	FSHU sh.a	106
22	Arka, Sauk	Sauk fshat	FSHU sh.a	55
23	KNK, Vore	Vore	FSHU sh.a	200
24	KNK, Pallatet Cabej	Pallatet Cabej Tirane	FSHU sh.a	54.2
25	KNK, Fresku	Linze Dajt	FSHU sh.a	188.3
26	KNK Fusha e Aviacionit	Ish fusha e aviacionit	FSHU sh.a	108
27	KNK, Durres	Lgj.Nr.4, Rr. "Skenderbej", Durres	FSHU sh.a	230
28	KNK zyra Durres	Durres	FSHU sh.a	245
29	KNK, Durres 2	Durres	FSHU sh.a	103.5
30	KNK, Durres 3	Durres	FSHU sh.a	140
31	KNK, Manze	Prane bashkise Manez	FSHU sh.a	65
32	KNK, Kavaje	Lagja nr.2, Rr.10 Korriku, Kavaje	FSHU sh.a	120
33	KNK, Fushe-Kruje	Lagja "SMT1"	FSHU sh.a	88
34	KNK, Rrogozhine	Rrogozhine	FSHU sh.a	154.2
35	KNK, Shijak	Prane komisiariatit	FSHU sh.a	90
36	KNK, Kruje	Lagjja Sesere	FSHU sh.a	196
37	Arka Golem	Golem	FSHU sh.a	47
38	KNK, Shkoder 1	Rruga "Kardinal Mikel Koliqi"	FSHU sh.a	355

39	KNK, Shkoder 2	Kompleksi Uraj ne te hyre te Shkodres	FSHU sh.a	193
40	KNK, Shkoder 3	Ne qender te Shkodres prane bashkise	FSHU sh.a	35
41	KNK, Shkoder 4	Qender Shkoder	FSHU sh.a	163
42	KNK, Bushat	Bushat	FSHU sh.a	180
43	KNK, Vau i Dejes	Vau i Dejes	FSHU sh.a	190
44	KNK, Lezhe	Lezhe	FSHU sh.a	114.4
45	KNK, Rrile	Lezhe	FSHU sh.a	238.5
46	KNK, Puke	Puke	FSHU sh.a	80
47	KNK, Koplik	Koplik	FSHU sh.a	50
48	Arke Fushe Arrez	Fushe Arrez	FSHU sh.a	45
49	Arke Velipoje	Velipoje	FSHU sh.a	45
50	KNK, Kukes	Lagja "Nr.4"	FSHU sh.a	135
51	KNK, Kukes 2	Lagjja nr 2	FSHU sh.a	148
52	KNK, Hasi	Qender,Has	FSHU sh.a	75
53	KNK, Tropoje	Lagja "28 Gushti"	FSHU sh.a	120
54	KNK, Burrel	Lagja "Pjeter Budi"	FSHU sh.a	125
55	KNK, Peshkopi	Lagja "Aksioni", Peshkopi	FSHU sh.a	135
56	KNK, Rreshen	Qender, Rreshen	FSHU sh.a	55
57	KNK, Shupenze	Shupenze	FSHU sh.a	40
58	KNK, Maqellare	Maqellare	FSHU sh.a	40
59	KNK, Kastriot	Kastriot	FSHU sh.a	60
60	Arke Mamurras	Mamurras	FSHU sh.a	20
61	KNK, Lac	Lagja tek "Xhamlleku"	FSHU sh.a	130
62	KNK, Rubik	Rubik	FSHU sh.a	40
63	KNK, Milot	Milot	FSHU sh.a	100
64	KNK Klos	Klos	FSHU sh.a	36

65	KNK, Bulqize	Lagja "Minatori", Bulqize	FSHU sh.a	49
66	KNK, Berat	Berat	FSHU sh.a	177
67	KNK, Ure Vajguore	Ure Vajguore	FSHU sh.a	60
68	KNK, Skrapar	Lagja "Clirimi"	FSHU sh.a	66
69	KNK, Polican	Polican	FSHU sh.a	28
70	KNK, Lushnje 2	Prara Bashkise Lushnje	FSHU sh.a	112
71	KNK, Lushnje	Lagja "Kongresi i Lushnjes" prane Gjykates	FSHU sh.a	145
72	KNK, Krutje	Krutje	FSHU sh.a	151.6
73	KNK, Divjake	Divjake qender	FSHU sh.a	28.5
74	KNK, Kucove	Kucove	FSHU sh.a	140
75	KNK, Fier	Rr. Ramiz Arianiti, "Lagja Kastriot"	FSHU sh.a	139
76	KNK, Fier 2	Fier	FSHU sh.a	96
77	KNK, Patos	Qender, Patos	FSHU sh.a	81
78	KNK, Roskovec	Roskovec	FSHU sh.a	31
79	KNK, Ballsh	Lagja "5 Shkurti", Ballsh	FSHU sh.a	220
80	KNK 2, Vlore	Kompleksi prane Conad	FSHU sh.a	170
81	KNK 3 Vlore	Prane transballkanikes	FSHU sh.a	150
82	KNK, Vlore	Lagja "Lirim" Rr.Demokracia, Vlore	FSHU sh.a	120
83	KNK, Orikum	Orikum	FSHU sh.a	29.6
84	KNK, Himare	Himare	FSHU sh.a	83.2
85	KNK, Elbasan	Lagja "Aqif Pasha"	FSHU sh.a	149.2
86	KNK, Elbasan 2	Prane stadiumit	FSHU sh.a	195.5
87	KNK, Librazhd	Perballe Postes	FSHU sh.a	70
88	KNK, Gramsh	Lagja "Sporti"	FSHU sh.a	75
89	KNK, Perrenjas	Perrenjas	FSHU sh.a	38
90	KNK, Cerrik	Cerrik	FSHU sh.a	50

91	KNK, Peqin	Lagja "Teqe", Peqin	FSHU sh.a	69
92	KNK, Korce	prane zyrrave te zones	FSHU sh.a	130
93	KNK, Bilisht	Bilisht,Qender	FSHU sh.a	179.6
94	KNK Maliq	Maliq	FSHU sh.a	88.1
95	KNK, Erseke	Rr. "Ahmet Bektashi", Erseke	FSHU sh.a	40
96	KNK, Pogradec	Lagja "Reshit Collaku" Pogradec	FSHU sh.a	120
97	KNK, Gjirokaster	Lagja "18 Shtatori"	FSHU sh.a	70
98	KNK, Sarande	Prane limanit te vjeter	FSHU sh.a	64
99	KNK Ksamil	Ksamil	FSHU sh.a	40
100	KNK, Delvine	Qender, Delvine	FSHU sh.a	80.5
101	KNK, Tepelene	Lagja "Mustafa Matohiti"	FSHU sh.a	115.2
102	KNK, Permet	Permet	FSHU sh.a	40
TOTALI NE SIPERFAQE				17,380.50

<i>Nr</i>	<i>Vendndodhja e Objektivit Zyre/KNK</i>	<i>Adresa</i>	<i>Shoqeria</i>	<i>Siperfaqja ne m²</i>
1	Zyrat Qendrore OSSH	Blv Gj. Fishta	OSSH sh.a	4,394.00
2	Zone Tirane	Rruga"Reshit Collaku"	OSSH sh.a	1,672.00
3	Njesia 1	Prapa Ministrise se Arsimit	OSSH sh.a	520
4	Njesia 2 Poligrafiku	Ish Profarma	OSSH sh.a	213
5	Njesia e regjistrimit te dhenave	Blloku Gintash Laprake	OSSH sh.a	192
6	Njesia DKRH Tirane	Ish Fusha e Aviacionit	OSSH sh.a	220
7	Arkiva Vaqarr	Vaqarr Tirane	OSSH sh.a	500
8	Magazina Laknas	Mezez Tirane	OSSH sh.a	600
9	Zone Berat	Lagja "30 Djetori"	OSSH sh.a	357
10	Njesia Berat	Berat	OSSH sh.a	200
11	Zyra Skrapar	Corovode	OSSH	100

			sh.a	
12	Zyra Njesia Lushnje	Lushnje	OSSH sh.a	240
13	Zyra Njesia Kucove	Kucove	OSSH sh.a	270
14	Zyra Kucove	Kucove	OSSH sh.a	120
15	Zone Fier	Lagja 1 Maji, Zona industriale	OSSH sh.a	590
16	Njesia Fier	Fier	OSSH sh.a	170
17	Zyra Ballsh	Ballsh	OSSH sh.a	176
18	Zyra Njesia Patos	Patos	OSSH sh.a	120
19	Zyra Drejtoria Vlore	Kompleksi Ujesjellsit Vlore	OSSH sh.a	800
20	Zone Elbasan	Lagja "28 Nentori"	OSSH sh.a	780
21	Zyra Njesia Librazhd	Librazhd	OSSH sh.a	120
22	Zyra Gramsh	Gramsh	OSSH sh.a	110
23	Zyra Peqin	Peqin	OSSH sh.a	80
24	Zone Korce	Bulevardi Republika	OSSH sh.a	365
25	Njesia Korce	Korce	OSSH sh.a	200
26	Zyra Bilisht	Bilisht	OSSH sh.a	120
27	Zyra Erseke	Erseke	OSSH sh.a	80
28	Zyra Pogradec	Pogradec	OSSH sh.a	140
29	Zone Gjirokaster	Lagja "18 shtatori"	OSSH sh.a	420
30	Njesia Gjirokaster	DPK Gjirokaster	OSSH sh.a	300
31	Zyra Permet	Permet	OSSH sh.a	105
32	Zone Sarande	Sarande	OSSH sh.a	360
33	Zone Durres	Rruga "9 Maji"	OSSH sh.a	1,200
34	Njesia Durres	Rruga Kristaq Rama	OSSH sh.a	450
35	Njesia Durres	Zona e Plazhit	OSSH sh.a	104
36	Zyra Kavaje	Kavaje	OSSH sh.a	120
37	Zyra Fushe Kruje	Lagja "SMT1"	OSSH	307.6

			sh.a	
38	Zyra Shijak	Prane komisiariatit	OSSH sh.a	236
39	Zone Burrel	Rruga "Ibrahim Tema"	OSSH sh.a	287
40	Njesia Burrel	Burrel	OSSH sh.a	120
41	Zyra Peshkopi	Prane zyrrave te njesise	OSSH sh.a	120
42	Zyra Rreshen	Qender, Rreshen	OSSH sh.a	62
43	Zyrat Bulqize	Bulqize	OSSH sh.a	120
44	Zone Shkoder	Lagja "Skenderbeg"	OSSH sh.a	570
45	Zyra Shkoder	Qender Shkoder	OSSH sh.a	326
46	Njesia Shkoder	Kompleksi Uraj ne te hyre te Shkodres	OSSH sh.a	400
47	Zyra Lezhe	Lezhe	OSSH sh.a	201
48	Zyra Puke	Qender,Puke	OSSH sh.a	120
49	Zyra Koplik	Koplik	OSSH sh.a	90
50	Zone Kukes	Lagja e re	OSSH sh.a	186
51	Zyra Tropoje	Bajram Curri	OSSH sh.a	199
52	Zyra Has	Has	OSSH sh.a	80
53	Zyrat e Tensionit te Larte	Prane vilave gjermane	OSSH sh.a	338.2
54	TL Tirane	Rr."Dervish Hima" prane stadiumit "Q.Stafa"	OSSH sh.a	619
55	Magazine dhe arkive TL	Autostrada Durres-Tirane km 8	OSSH sh.a	320
56	TL Burrel	Rreshen	OSSH sh.a	200
57	TL Fier	Fier	OSSH sh.a	556.7
58	TL Saranda	Qafe gjashte, prane n/stacionit	OSSH sh.a	100
59	TL Elbasan	Lagja "28 Nentori"	OSSH sh.a	224.8
	TOTALI NE SIPERFAQE			22,291.30
	VLERAT TOTALE PER SHOQERITE			39,671.80

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Shërbimi që kërkohet: ” Shërbim i pastrimit për zyrat dhe Qëndrat e Kujdesit Ndaj Klientit të OSHEE Group sh.a”

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

- 1.** Shërbimi i pastrimit do të kryhet në të gjitha pikat ku OSSH sh.a dhe FSHU sh. a ushtron aktivitetin e saj sipas listës së mësipërme.
- 2.** Shërbimi do të ofrohet çdo ditë pune të javës nga ora 07:00 AM-09:00 AM
- 3. Shërbimi i pastrimit do të përfshijë:**
 - a. Pastrimin ditor të kateve dhe ballkoneve
 - b. Pastrimin ditor të dritareve nga brenda
 - c. Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme prej xhami një herë në muaj
 - d. Pastrimi i sipërfaqeve të jashtme prej xhami një herë në muaj
 - e. Pastrimi ditor dhe fshirja e pluhurave nga dyert dhe mobiljet
 - f. Pastrimi ditor i kuzhinave dhe pajisjeve të tyre
 - g. Pastrimi ditor i tualeteve
 - h. Pastrimi ditor i të gjitha koshave të mbeturinave
 - i. Kujdesi ditor për hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara nga Pushteti Vendor
 - j. Shërbimi i dezinfektimit minimum një herë në muaj dhe për çdo event të lajmëruar paraprakisht nga administratori i kontratës
- 4. Ofruesi i Shërbimit merr përsipër të sigurojë në të gjitha pikat ku do të ofrohet shërbimi i pastrimit:**
 - Leter Higjenike

-
- Peshqire letre
 - Sapun te lengshem
 - Qese plastike per plehrat
 - Dezinfektant duarsh me baze alkooli min 60%
 - Te gjithë detergjentet e nevojshem per ofrimin e sherbimit
 - Te gjithë aksesoret dhe pajisjet e nevojshme per ofrimin e sherbimit

5. Ne cmimin e ofruar duhet te perfshihen shpenzimet per:

- Kosto personeli
- Taksa dhe tatime qe burojne nga aktiviteti apo sherbimi i ofruar
- Detergjentet, aksesoret, pajisjet e pastrimit dhe transporti i tyre
- Sherbimi i dezinfektimit duhet te ofrohet sipas percaktimeve te udhezimit te perbashket APP dhe MSHMS nr 294 date 06.05.2020 (ose ne perputhje me cdo ndryshim qe mund te pesoje ky udhezim pergjate zbatimit te kontrates)

Shenim: Ne zyrat e Administrates Qendrore, FSHU sh.a dhe OSSH sh.a do te kete 7 punonjese te dedikuara dhe zyrat e Drejtorise Rajonale Tirane do kete 2 punonjese te dedikuara cdo dite te javes nga e hena ne te premte, Orari 08:30 - 17:00 Ne keto dy objekte do te behet pastrim i pergjithshem cdo te shtune.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë licencën e mëposhtme:

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (dezinfektim).

2.3.3 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 42 (dyzet e dy) persona të punësuar, te cilet duhet të jene te listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik për muajin e fundit (*duke marrë si reference data e hapjes se ofertave*), në profilet sipas tabelës se mëposhtme:

Stafi	Nr.
Drejtues Teknik	1 (një)
Punonjes shërbimi/Sanitar	30(tridhjetë)
Punonjes i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë	1 (një)
Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë	1 (një)
Shofer për transport materiale	4 (kater)
Punonjes dezinfektimi	4(kater)
Shofer për platformen levizëse	1 (një)
Totali i punonjësve	42 (dyzet e dy)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

➤ **Për Drejtuesin Teknik OE duhet të paraqesë:**

- Diplomë
- Kontrate pune perkatëse.

Për të vërtetuar disponimin e stafit të mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, (*duke marrë si reference data e hapjes se ofertave*) dhe Vertetim nga Dega e Tatim Taksa ose Dega e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të leshuar nga Administrata Tatimore, ku të pasqyrohet numri i punonjësve për muajin e fundit, (*duke marrë si reference data e hapjes se ofertave*).
- **Per punonjësit punonjes shërbimi/Sanitare**, të paraqitet vetëm kontrate pune perkatëse nga keta të pakten 3 punonjes për punime në lartësi të pajisur me certifikata trajnimit për punime në lartësi (për shkak të pastrimit të fasadave në lartësi) për ndjekjen/zbatimin e kontratës.
- **Për punonjesin e specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë** sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” duhet të paraqesë:
 - kontrate e pune perkatëse dhe certifikate
- **Per specialistin e kualifikuar** sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë – minimalisht 1(një), sipas Udhezimit të përbashkët APP dhe MSHMS nr 294 datë 06.05.2020 (ose në përputhje me cdo ndryshim që mund të pesoje ky udhëzim përgjatë zbatimit të kontratës) duhet të paraqesë:

- kontrate e punes perkatese dhe certificate

➤ **Per punonjesit shofere transporti** duhet te paraqese;

- kontraten e punes perkatese dhe leje drejtimi

➤ **Per punonjesit e dezinfektimit** duhet te paraqese;

- kontraten e punes perkatese

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatës të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) ISO 9001 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) ISO 45001:2018 (Standard Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
- 3) ISO 14001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësisë të mjedisit (e vlefshme);.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.5 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

-
1. Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh - minimumi 10 cope
 2. Makineri larje-tharje- minimumi 3 cope
 3. Fshesa korenti - minimumi 10 cope
 4. Paisje për larjen e dritareve me gjatësi mbi 10 metra- 1 cope

Per te provuar disponimin e makinerive profesionale me parametrat e kerkuar, operatori ekonomik duhet te paraqese kataloge / skede teknike per makinerite profesionale, ku te pasqyrohen te dhenat e kerkuara me siper.

Për makineritë me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore /zhdoganim/kontrate blerje).

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatës të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon platformë lëvizëse për ngritjen e njerëzve, për punimet në lartësi.

Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni I tij (leje qarkullimi, kolaudim, sigurim i detyruar TPL, foto. se bashku me specifikimet teknike te krahut **ku te tregohet lartësia mbi 15 metra)**

Per mjetet me qira duhet te paraqitet kontrata e qirase e lidhur para noterit, me afat per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, e shoqeruar me dokumentacion qe verteton pronesine e qiradhenesit (leje qarkullim, kolaudim, leje transporti, sigurim i detyruar TPL foto dhe raporti i inspektimit te konformitetit) se bashku me specifikimet teknike te krahut (te perkthyer dhe te noterizuara) **ku te tregohet lartësia mbi 15 metra.**

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatës të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetohet se disponon:

- *Mjete transporti per punonjesit dhe mallrat – minimalisht 4 (kater) cope*

Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni i tij (leje qarkullimi, kolaudim, sigurim i detyruar TPL, foto.)

Per mjetet me qira duhet te paraqitet kontrata e qirase, me afat per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, e shoqeruar me dokumentacion qe verteton pronesine e qiradhenesit (leje qarkullim, kolaudim, leje transporti, sigurim i detyruar TPL foto.)

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit **përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatës të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Licence DDD te vlefshme, (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim).

Gjitashtu ne kete kuader Operatori ekonomik duhet te provoje disponimin e minimumi **10 pompa dezinfektimi (Pompa profesionale per sperkatjen e dezinfektantit, 5 pompa ULV,** dhe 1 pajisje mjegulluese që të operojë me parimin e injektimit të lëngshëm në gazrat e nxehta.

Për vërtetimin e disponimit te ketyre pajisjeve, operatori ekonomik mund ti disponoje ne pronesi ose me qira, ne varesi te menyres se disponimit duhet të paraqesë faturat e blerjes/zhdoganimit/kontrata qeraje së bashku me specifikimet teknike të pajisjes .

Termat e sherbimit do te jene sipas percaktimeve te Udhezimit te perbashket te APP dhe MSHMS nr. 294, date 06.05.2020.

